

Misioni

WageIndicator Foundation i dedikohet transparencës në tregun e punës në nivelin botëror, duke ofruar në faqet e tij të internetit informacione falas, të besueshme dhe me cilësi të lartë.

Këto faqe interneti përmbajnë informacione lidhur me pagat sipas profesioneve, pagat jetike, pagat minimale, ligjet kombëtare të punës, marrëveshjet kolektive dhe vendet e lira të punës.

WageIndicator Foundation

WageIndicator Foundation është organizatë jofitimprurëse dhe joqeveritare, e cila është themeluar në vitin 2003.

Faqja WageIndicator.org menaxhon faqet kombëtare të internetit të shumë vendeve në pesë kontinente, faqe këto të cilat përmbajnë informacione për vendet e punës.

Fondacioni përdor uebsajtet kombëtare për të mbledhur, krahasuar dhe shpërndar informacione lidhur me pagat, ligjet e punës dhe mundësitë për karrierë.

Çdo uebsajt ka qindra faqe dhe menaxherët e tij sigurojnë që përmbajtja të përditësohet vazhdimisht.

Teknika e Optimizimit të Motorëve të Kërkimit (SEO) zbatohet në mënyrë rigorozë, meqenëse pjesa më e madhe e vizitave kryhen përmes motorëve të kërkimit.

WageIndicator-i u dërgon rregullisht të abonuarve buletine informative.

Mediet sociale përdoren për projekte që u drejtohen popullatave specifike.

Vizitorët i vlerësojnë shumë uebsajtet, ndërkohë që në shkallë botërore, WageIndicator-i tërheq dhjetëra milionë vizitorë.

Besimi i vizitorëve te faqet e internetit sigurohet përmes bashkëpunimit me universitete, partnerë socialë, medie dhe OJQ.

Fondacioni WageIndicator i fton vizitorët herë pas here që të plotësojnë Anketën për Pagat dhe atë për Kostot e Jetesës (anketa këto të cilat janë në shumë gjuhë) ose të dërgojnë marrëveshjet e tyre kolektive.

Historiku

Fondacioni WageIndicator i ka fillesat në Holandë.

Uebsajti i parë, Loonwijzer.nl, i hapur në vitin 2001, shërbente si indikator pagash që përdorej me lehtësi nga punëtorët që kërkonin informacione për pagat.

Brenda një kohe të shkurtër, ky uebsajt u bë mjaft i njohur në radhët e punëtorëve, punëdhënësve dhe punëkërkuesve që kërkonin informacione lidhur me pagat.

Në vitin 2004 ky uebsajt u paraqit në vendet fqinje e më pas edhe në vende jashtë Evropë.

Në vitin 2008, më shumë sesa 60 vende kishin një uebsajt, ndërkohë që në vitin 2017, ky numër arriti në 92.

Fondacioni ka një ekip botëror dhe selinë në Holandë. Zyrat e tij ndodhen në Islamabad, Ahmedabad, Buenos Aires, Kejp Taun, Venecie.

Projektet

Që prej themelimit, Fondacioni WageIndicator ka realizuar projekte me një gamë partnerësh si në vendet e zhvilluara po edhe ato në zhvillim.

Fondacioni WageIndicator ka bashkëpunuar edhe me konsorciume kërkimore ndërkombëtare për projekte që kanë për qëllim analizimin e qëndrimeve ndaj raportit "punë-jetë", ndërtimin e një baze globale me të dhëna për punësimin, shqyrtimin e pagave dhe kushteve të punës në sipërmarrjet shumëkombëshe dhe metodat e testimit në anketa.

Në këto projekte bëjnë pjesë aktivitete që kryhen përmes internetit, siç janë komunikimi mediatik në vendet e BE-së lidhur me hendekun gjinor të pagave, por edhe aktivitete në terren, si: debate me partnerë socialë lidhur me procesin e marrëveshjeve kolektive në Amerikën Latine, intervistat ballë për ballë me punonjësit e sektorit të veshmbathjeve në Indonezi dhe Etiopi, duke përdorur anketën Punë të Përshtatshme (Decent Works), të plotësuar me tableta; apo të drejtat e punës për gratë në Afrikë dhe Azi.

Bazat e të dhënave

Bazat e të dhënave përditësohen për të furnizuar me përmbajtje faqet e uebsajteve. Të tilla baza të dhënash janë:

- Baza e të dhënave "VIP", e cila përmban informacione lidhur me pagat që marrin yjet e kinematografisë, kryetarët e shteteve dhe "Persona të tjerë Shumë të Rëndësishëm", të cilat gjenden në të gjitha faqet e internetit për të tërhequr audiencën e uebsajtit
- Baza e të dhënave për pagat, e cila përmban të dhëna të mbledhura përmes Anketës së Pagave të WageIndicator-it dhe nga anketa të disponueshme kombëtare, të cilat gjenden në pjesën "Verifikimi i Pagës", e cila ndodhet në të gjitha uebsajtet
- Baza e të dhënave për pagat jetike, e cila përmban të dhëna të mbledhura përmes anketës për Kostot e Jetesës të WageIndicator-it, anketë kjo e cila përbëhet nga disa qindra pyetje. Të dhënat e kësaj baze paraqiten në formën e hartave në pjesën "Pagat në kontekst"
- Baza e të dhënave për pagën minimale, e cila përmban të dhëna që mblidhen nga personeli i WageIndicator-it nga qeveritë kombëtare apo rajonale, përmban të dhëna për normat dhe mekanizmat e pagës minimale, të paraqitura në të gjitha uebsajtet
- Baza e të dhënave për ligjet e punës, e cila përmban të dhëna që personeli i WageIndicator-it mblidh nga qeveritë kombëtare dhe që ndodhen në uebsajtet kombëtare. Të dhënat kategorizohen në 50 tema
- Baza e të dhënave për marrëveshjet kolektive, e cila përmban informata që personeli i Fondacionit WageIndicator mblidh nga partnerët socialë dhe që paraqiten në uebsajtet kombëtare në formën e teksteve të anotuara. Të dhënat kodohen sipas marrëveshjeve

Contact:

E-mail: office@wageindicator.org

Web: www.wageindicator.org

sq_AL